

VENDIM
Nr.1693, datë 24.12.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.21, DATË 9.1.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS DHE TË
NUMRIT TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE, NË NJËSITË E
QEVERISJES VENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 58 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2008 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pasqyrën nr.2 “Qarku Dibër, zyra e gjendjes civile, komuna Selishtë”, që i bashkëlidhet vendimit nr.21, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet një përgjegjës, shtesë e cila të reflektohet edhe në organikën e zyrave të gjendjes civile, në bashki e komuna.
2. Efektet financiare të përballohen nga të ardhurat e komunës.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha